

PREFEKTURA DIBËR
Ardhur
Nr. 1022 dt. 06.11.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 4457 Prot

Peshkopi, më 06.11 .2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.77

Datë: 03.11.2025 si dhe projekt-vendimin nr.01 Datë 28.10.2025

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TAKSI NË BASHKINË DIBËR”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak



Keqyo
06.11.2025



6697/ 12/11/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.1022/1 prot.

Peshkopi, më 12.11.2025

Lënda: Kthim i vendimit nr.77, datë 03.11.2025 të Këshillit Bashkiak Dibër.

BASHKISË DIBËR

KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.77, datë 03.11.2025 “**Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Dibër**”, konstatova se:

Miratimi i aktit objekt verifikimi është bërë pa u zhvilluar seancë këshillimi me bashkësinë, e detyrueshme në rastin konkret sipas parashikimeve të nenit 18 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Më konkretisht, në nenin 18 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, parashikohet:

“Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet 54, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, dhe 77, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, të këtij ligji”.

Ndërkohë në nenin 54 shkronja “k” të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar parashikohet:

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca: ...

k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;

Në rastin konkret, me aktin objekt verifikimi (vendim nr.77, datë 03.11.2025) janë miratuar norma, standarte e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e shërbimit të transportit publik, si një funksion i bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, përcaktuar në nenin 23 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar.

Sa më sipër, referuar parashikimeve të 18 pika 1 dhe nenit 54 shkronja “k” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, në kushtet e mos zhvillimit të seancës së këshillimit me bashkësinë, vendimi objekt verifikimi, nuk mund të marrë konfirmimin e Prefektit.

P R E F E K T I

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 77 Datë 03 /11 /2025

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TAKSI NË BASHKINË DIBËR”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1, germat 'a' dhe 'b', nenit 64, germa 'a' dhe 'b' të ligjit nr. 139/2015 'Për veteqeverisjen vendore'; Ligjin nr. 8308, date 18.03.1998 'Për transportet rrugore', i ndryshuar; Ligji Nr. 8378, date 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë “ i ndryshuar, VKM nr 325 date 19.03.2008 “Për përcaktimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare të caktuara për këta operatorë” i ndryshuar, Udhezimin nr 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve , rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit” i ndryshuar,Udhëzimin nr.15 datë 24.07.2007. “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” i ndryshuar.Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **03.11.2025** me 19 vota pro 0 kundër 0 abstenim :

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Dibër, sipas aneksit 1, bashkelidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall më datë **03.11.2025**.

Kryetar i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DIBER
DREJTORIA TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
SEKTORI I LICENCAVE DHE KONTROLLIT

PROJEKT-VENDIM

Nr 01 datë 28/10 /2025

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TAKSI NË BASHKINË DIBËR”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1, geramat 'a' dhe 'b', nenit 64, gërma 'a' dhe 'b' të ligjit nr. 139/2015 'Per vetqeverisjen vendore'; Ligjin nr. 8308, date 18.03.1998 'Per transportet rrugore', i ndryshuar, Ligji Nr. 8378, date 22.07.1998 "Kodi Rrugor I Republikes se Shqiperise " i ndryshuar, VKM nr 325 date 19.03.2008 "Per percaktimin e rregullave per pranimin ne veprimtarine e operatorit te transportit rrugor te mallrave dhe te udhetareve si dhe per njohjen e dokumenteve zyrtare te caktuara per keta operatore" i ndryshuar, Udhezimin nr 5627, date 18.11.2016 "Per percaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit per leshimin e licencave dhe certifikatave per ushrimin e veprimtarise ne transportin rrugor te udhetareve brenda vendit" I ndryshuar, Udhezimin nr 15 date 24.07.2007. "Per kriteret dhe procedurat e leshimit te licencave, autorizimeve dhe certifikatave per ushrimin e veprimtarise ne transportin rrugor" i ndryshuar, Sektori i licencave dhe i kontrollit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore:

KËRKOJMË:

1. Të miratohet rregullorja për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Dibër, sipas aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projekt- vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe konfirmimit nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.

Për Bashkinë Dibër:

Sektori i Licencimit dhe Kontrollit

Altin Tomçini

Drejtoria Juridike

Ismet Saraçi

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

Fitim Raska

Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit


Blerina Mazari

KRYETARI I BASHKISË

Rahim Spahiu

Ne mungese dhe me porosi

Corenc Cibaku





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
SEKTORI I LIÇENCAVE DHE KONTROLLIT

RELACION

**“ Mbi miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e shërbimit
Taksi në Bashkinë Dibër”**

Mbështetur në nenin 35 e vijues të Ligjit Nr. 8308 datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, ku citon: "Këshilli i Bashkisë përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij shërbimi brenda territorit të vet" Ligji Nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë " i ndryshuar, Udhëzimin nr 15 datë 24.07.2007. "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave , autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" i ndryshuar Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore , Sektori i Liçensimit dhe i Kontrollit merr në shqyrtim të gjitha kërkesat dhe problematikat që kanë të bëjnë me fushën e transportit , liçencimit, lejet mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e tyre.

Duke u bazuar në faktin se kërkesat dhe numri i subjekteve taksi të liçensuara dhe të atyre që kerkojnë të liçensohen është në rritje , e shohim të nevojshme që bazuar në legjislacionin në fushën e transportit, miratimin e një rregulloreje për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Dibër , , në menyrë që të sigurojë një shërbim cilësor dhe të besueshëm tek qytetarët të formalizojë tregun dhe të ulë konkurrencën e pandershme nga transporti i palicësuar si dhe në rritjen e të ardhurave për Bashkinë Dibër.

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Drejtori

Fitim Raska

Sektor i Liçensimit dhe i Kontrollit

Altin Tomçini

ANEKSI 1

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TAKSI NË BASHKINË DIBËR

Neni 1 Qëllimi

Miratimi i kësaj rregulloreje ka për qëllim që Bashkia Dibër në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për transportin rrugor të sigurojë një shërbim cilësor dhe të besueshëm tek qytetarët, të formalizojë tregun dhe të ulë konkurrencën e pandershme nga transporti i palicencuar, të sigurojë udhëtarët të çilët përdorin këtë lloj transporti, pasi licencimi parashikon kontrollin fizik të automjeteve dhe verifikimin e drejtuesve të tyre, si dhe të ndikojë në rritjen e të ardhurave fiskalë për Njësinë Vendore Bashkinë Dibër

Neni 2 Objekti

Kjo rregullore përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimit "TAKSI" në Bashkinë Dibër dhe shttrin fushën e zbatimit mbi personat fizikë apo juridikë që ushtrojnë apo kërkojnë të ushtrojnë këtë aktivitet, si dhe detyrimin e administratës së bashkisë për zbatimin e dispozitave ligjorë në fuqi dhe të kësaj rregulloreje.

Neni 3 Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 23, pika 6, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; Kreut II.4 të Ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 për "Transportet Rrugore" (i ndryshuar); nenit 85 të Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar); nenit 2, nenit 3, pika 3 të Ligjit nr.115/2014, datë 31.07.2014 për "Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar); Ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 për "Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.325, datë 19.03.2008 për "Miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të çaktuara për këta operatorë" (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit nr.1649, datë 16.08.1999 mbi "Plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve" (i ndryshuar); Udhëzimit nr.20, datë 10.10.2007 për "Modelet e licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" (i ndryshuar); Udhëzimit nr.12, datë 19.07.2007 për "Përcaktimin e numrit të autoveturave taksi, shtypjen dhe emëtimin e licencave, bllokut të udhëtimit dhe regjistrimit të shërbimit taksi" (i ndryshuar); Udhëzimit nr.15, datë 24.7.2007 për "Kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" (i ndryshuar); Udhëzimit nr. 5627,; datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit" (i ndryshuar).

Neni 4 Përkufizime

1. **Taksi** - mjet motorik i prodhuar vetëm për transportin e udhëtarëve me vende të ulura jo më pak së 4 dhe jo më shumë se 8 persona, përveç atij të drejtuesit të automjetit, që ka jo më pak se katër dyer për autoveturat dhe jo më pak se tre dyer funksionale për mikrobuzët, dhe është i pajisur me taksimetër.
2. **Shërbim taksi** - është shërbimi publik që siguron një transport të menjëhershëm e të drejtpërdrejtë të udhëtarëve dhe të bagazheve të tyre
3. **Taksimetër** - nënkupton një instrument matës. i cili, në përputhje me karakteristikat e mjetit ku vendoset dhe tarifatat për të cilat fiksohet, llogarit, në mënyrë automatike dhe të vazhdueshme, shuimën që do të paguhet nga përdoruesi i mjetit i quajtur taksi në bazë të distancës së përshkruar ose kohës për të çilën mjeti është përdorur.
4. **Liçencë** - është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën për të zhvilluar tipin e veprimtarisë dhe sipas kushteve të përcaktuara në të.
5. **Subjekti i liçencuar** - është personi fizik apo juridik që i është lëshuar liçenca përkatëse nga Bashkia
6. **Drejtues i automjetit taksi** - është çdo shtetas shqiptar apo i huaj (i pajisur me dokumentacion qëndrimi) i çili ka shkallën e nevojshme të kualifikimit për të ushtruar këtë veprimtari.
7. **Kushtet e liçencimit** - janë ato kushte, kënaqja dhe respektimi i të cilave është i detvrueshëm nga kërkuesi, apo mbajtësi i liçencës në ushtrimin e shërbimit të transportit të udhëtarëve.
8. **Dokument provues** - është akt shkresor i një institucioni publik, privat, apo akti i përgatitur nga vetë kërkuesi që provon kënaqjen e një kushti të liçencimit.
9. **Dokument tjetër shoqërues** - është një dokument tjetër detyrues i kërkuar nga strukturat e liçencimit për t'u paraqitur dhe që nuk është dokument provues.
10. **Strukturat e liçencimit** - Janë Drejtoritë, Sektorët apo Zyrat të çilat administrojnë liçencimin e subjekteve të interesuara.
11. **Tarifa** - është vlerë monetare që paguhet për kryerjen e shërbimit.
12. **Udhëtar** - është çdo shtetas shqiptar apo i huaj që ka kërkuar, apo po i ofrohet shërbimi taksi.
13. **Bagazhe** - janë sende të çilat transportohen bashkë me udhëtarin,

Neni 5 Organizimi

1. Shërbimi i transportit të udhëtarëve me taksi organizohet si shërbim alternativ, për plotësimin e nevojave të komunitetit për transport në intenerare të lira. Ky shërbim organizohet në dy forma:
 - a) Transport udhëtarësh më taksi 4+ 1
 - b) Transport udhëtarësh më taksi 8+ 1
2. Në organizimin e transportit të udhëtarëve me taksi, bëhet një shpërndarje sa më e mirë e ofertës së transportit në të gjithë territorin administrativ të bashkisë.

Neni 6 Funksionimi

Shërbimi i transportit të udhëtarëve me taksi, funksionon në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në zbatim të kësaj rregulloreje. Parimi bazë për funksionimin e këtij shërbimi është ndërthurja e tij me llojet e tjera të transportit të udhëtarëve.

Neni 7 **Pranimi në treg**

- 1) Janë subjekt liçencimi, personat fizikë dhe juridikë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në fushën e transportit të udhëtarëve me taksë.
- 2) Miratimi i liçencës bëhet me vendim të Kryetarit të Bashkisë.

Neni 8 **Liçencat**

1. Ushtrimi i veprimtarisë së transportit të udhëtarëve taksë i nënshtrohet liçencimit.
2. Numri i liçencave për automjetet e shërbimit taksë 4+ 1 për Bashkinë Dibër është i pakufizuar.
- 3) Raporti i liçencave të taksive 4+1 me liçencat e taksive 8+1 për Bashkinë Dibër do të jetë 10 % .(në çdo 10 mjete taksë 4+1 do të ketë 1 mjet taksë 8+1)

Neni 9 **Shqyrtimi**

Liçencimi i subjekteve (Fizikë dhe Juridikë), të cilët do të operojnë në shërbimin taksë 4+ 1 dhe 8+ 1, do të kryhet mbi bazën e shqyrtimit korrekt dhe transparent të dokumentacionit provues dhe shoqërues. Brenda afatit 60 ditë kalendarike nga data e aplikimit subjekti mer përgjigjen nëse ka fituar të drejtën e liçencimit.

Neni 10 **Paraqitja e dokumentacionit**

Dokumentacioni për aplikim, paraqitet pranë Zyrës së Liçencimit, në Bashkinë Dibër çdo ditë pune nga ora 8:00 deri në orën 16:00. Dokumentacioni paraqitet nga vetë aplikanti, ose persona të autorizuar me prokurë për subjektet fizikë, dhe nga administratori ose person i autorizuar prej tij për subjektet juridikë.

Neni 11 **Numri i liçencave për subjektet fizikë dhe juridikë**

Çdo subjekt fizik mund të aplikoj vetëm për një liçencë dhe me një automjet, ndërsa personat juridik aplikojnë në një numër jo më pak së 2(dy) mjete.

Neni 12 **Zotërimin e mjeteve të nevojshme në uumrin dhe gjendjeu e kërkuar**

1. Subjekti fizik paraqet dokumentacionin për një mjet. Ky automjet duhet të jetë në pronësi të subjektit fizik
2. Subjekti juridik paraqet dokumentacion për ato automjete për të cilat kërkon të liçencohet. Këto automjete duhet të jenë në pronësi apo të marra me qera nga subjekti juridik.
3. Për gjendjen teknike të kërkuar të automjetit, është e nevojshme që subjektet të dorëzojnë dokumentacionin e gjendjes teknike të automjetit të lëshuar nga Qendra e Kontrollit Teknik.

Neni 13
Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Aplikimi duhet të përmbajë dokumentin origjinal ose të njëhsuar me origjinalin, si më poshtë:

1.1 Faza e parë

A. Personi fizik:

1. Kërkesë me shkrim;
2. Formulari i autodeklarimit;
3. Ekstrakt nga akti i regjistrimit pranë QKB-së;
4. Lejen e drejtimit në kategorinë përkatëse;
5. Dëshminë e Aftësisë Profesionale të personit fizik;
6. Lejen e qarkullimit për automjetin;
7. Vërtetim që është banor i Bashkisë Dibër jo më pak së tre vjet;
8. Vërtetim për shlyerje të detyrimeve vendore pranë Bashkisë;
9. Vërtetim për shlyerje të detyrimeve në Drejtorinë Rajonale Tatimore;
- 10 Vërtetim për detyrimet nga Zyra Përmbartimore;
11. Dokumentacion që vërteton se kapitalet dhe asetet e subjektit nuk janë në duart e Përmbartimit Gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestro për to.
12. Dëshmi penaliteti;
- 13 Vërtetim nga prokuroria;
14. Vërtetim nga gjykata;
15. Dokumentin e kredibilitetit bankar që vërteton gjendje të përshtatshme financiare (Vërtetim origjinal për vlerën jo më pak se 140 000 lekë),

B. Person juridik:

1. Kërkesë me shkrim;
2. Formulari i autodeklarimit të administratorit;
3. Lejen e qarkullimit për çdo mjet dhe kontratën e qiramarrjes në rast qiramarrje të automjetit;
4. Vërtetim që e ka selinë në Bashkinë Dibër;
5. Vërtetim për shlyerje të detyrimeve vendore pranë Bashkisë;
6. Vërtetim për shlyerje të detyrimeve pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore;
7. Dëshmi penaliteti për Administratorin;
8. Vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata për Administratorin;
9. Dokumentin e kredibilitetit bankar që vërteton gjendje të përshtatshme financiare (Vërtetim origjinal për vlerën jo më pak se 140 000 lekë për mjetin e parë dhe 70 000 lekë për çdo mjet shtesë)
10. Ekstraktin e regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit, ku të pasqyrohen edhe targat e automjeteve që kërkohen të liçencohen.

1.2 Faza e dytë:

A. Person fizik:

1. Lejen e qarkullimit me ngjyrën e mjetit të miratuar nga Bashkia,

2. Dokumentin e verifikimit dhe plumbosjes së taksimetrit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit;
3. Akt vlerësimin e plotësimin të kushteve të komoditetit të mjetit në shërbimin taksi;
4. Fletën e rezervimit të targës së verdhë të automjetit taksi,
5. Sigurimi i përgjegjësisë së pronarit të mjetit të transportit për dëme shkaktuar palëve të treta;
6. Siguracioni i pasagjereve;
7. Kontrolli teknik.

B. Person juridik:

1. Lejen e drejtimit në kategorinë përkatëse për drejtuesin e automjetit taksi;
2. Dëshminë e Aftësisë Profesionale të drejtuesit të automjetit taksi;
3. Dëshmi penaliteti për drejtuesin e automjetit taksi;
4. Vërtetim nga gjykata dhe prokuroria për drejtuesin e automjetit taksi;
5. Kontratën e punës për drejtuesin e automjetit taksi me afat jo më pak se një vit;
6. Lejen e qarkullimit me ngjyrën e mjetit të miratuar nga Bashkia;
7. Dokumentin e verifikimit dhe plumbosjes së taksimetrit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit.
8. Akt vlerësimin e plotësimin të kushteve të komoditetit të automjetit,
9. Fletën e rezervimit të targës së verdhë të automjetit taksi;
10. Sigurimi i përgjegjësisë së pronarit të automjetit të transportit për dëme shkaktuar palëve të treta;
11. Siguracioni i pasagjereve;
12. Kontrolli teknik.
13. Vërtetim për drejtuesin e mjetit që është banor i Bashkisë Dibër jo më pak se tre vjet,

2. Struktura përkatëse e liçencimit në Bashki mund të kërkojë dokumentacion shtesë në qoftëse e gjykon të nevojshme.
3. Subjekteve që u është miratuar liçenca në fazën e parë mund të ndryshojnë automjetet më të cilët kanë aplikuar, por automjeti i ri duhet të përmbushë të njëjtat kushte dhe kritere, ose më të mira se automjeti i zëvendësuar.
4. Për subjektet që janë të pajisur me liçencë në raste rinovimi nuk aplikohet pika 1.2 B, 13 për person juridikë dhe pika 1.1 A 7 për personat fizikë.

Neni 14

Proçesi i shqyrtimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i dorëzuar për liçencim shqyrtohet nga stafi i zyrës së liçencave pranë Bashkisë. Hartohet materiali së bashku me relacionin përkatës dhe i dërgohet Kryetarit të Bashkisë për vendimarrje.

Neni 15

Refuzimi i kërkesës për liçencim

1. Kërkesa për liçencim refuzohet kur subjekti që kërkon të liçencohet:
 - a) Nuk plotëson kërkesat sipas kësaj rregulloreje;
 - b) Ka paraqitur informacion jo korrekt në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e liçencës;
 - c) Provohet se deklaratimet nga personi për marrjen liçencës janë të pavërteta,

2. Në rast se subjektit i është refuzuar kërkesa për liçencim, atëherë atij i lind e drejta për ankim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim.
3. Organi përkatës që shqyrton ankesën është Kryetari i Bashkisë, ose personi i autorizuar nga Kryetari, por asnjëherë struktura që ka shqyrtuar aplikimin fillestar. Shqyrtimi i ankimit bëhet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së tij, ku Kryetari i Bashkisë del me vendim përfundimtar.

Neni 16

Shtypja e liçencave

Strukturat përkatëse të liçencimit në Bashki dërgojnë pranë D.P.SH.T.RR kërkesat e tyre për shtypjen e liçencave.

Neni 17

Liçenca

1. Liçenca lëshohet nga Kryetari i Bashkisë.
2. Liçenca do të jetë me afat deri në 5 vjet, me të drejtë rinovimi.
3. Liçenca do të lëshohet kundrejt tarifave përkatëse të miratuara.
4. Liçenca nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj tek një subjekt tjetër.

Neni 18

Fillimi i aktivitetit

1. Subjekti përfitues duhet detyrimisht të fillojë shërbimin brenda 60 ditëve, nga lëshimi i liçencës. Ai mund të përfillojë një shtyrje afati me 30 ditë, me miratim të Kryetarit të Bashkisë,
- 2 Çdo ndërprerje e shërbimit për më shumë se 30 ditë duhet t'i komunikohet strukturave të liçencimit në Bashki.

Neni 19

Arkivimi i liçencave dhe i dokumentacionit

1. Struktura e liçencimit mban shënime të plota pranë Arkivit të Bashkisë, për dorëzimin e praktikave të subjekteve dhe të dhënies së liçencave.
2. Dokumentacioni që arkivohet duhet të përmbajë:
 - a) Dokumentacionin që është dorëzuar nga aplikanti;
 - b) Vendimin e Kryetarit të Bashkisë për miratimin apo mosmiratimin e liçencës;
 - c) Për rastet e rrratimit të liçencës, fotokopjç të liçencës së lëshuar;
 - d) Në rast mosmiratimi, dokumentacioni ruhet deri në përfundimin e afatit për ankim dhe më pas i kthehet subjektit aplikues.

Neni 20

Procedurat për ndryshimin e automjetit

Në rast të dëmtimit të riparueshëm, mospërmbyshjes së kriterit të vitit të prodhimit të pëcaktuar në këtë rregullore, si dhe arsyeve të tjera të ligjshme, subjekti i liçencuar mund të ndryshojë automjetin taksit të liçencuar

Subjekti paraqet këto dokumenta:

- a) Lejen e qarkullimit për automjetin për të cilën aplikohet;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHETËTËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: 2932

KODI UNIK: 2932024222

NUMRI PASURISË: 12/24+1-6

INDEKSI HARTËS: PE-E,F-3,4

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 1000

DREJTORI
Danjel Gjura

Digitally signed by:
Florina Prethi
Date: 2025.09.03
10:24:02 +02'00'


Digitally signed by:
Danjel Gjura
Date: 2025.09.03
11:27:33 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Dibrë
Date: 2025/09/03 10:24:09 +02'00"
H71010004G202509031023541314014

SHPJEGUES

- PARCELA
- NDËRTESA




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Dibër

Njësia administrative Peshkopi

Zyra e Gjendjes Civile 32



Datë: 17.09.2025

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.	Emri DODA	Xhelil	Rufie	M	Kryefamiljar	10-10-1977	I/e martuar	Vakuf, Diber	Shqiptare	H71010004G
2.	Florina DODA	Shuip	Muzafere	F	Bashkëshorte	03-02-1984	I/e martuar	Pilafe, Diber	Shqiptare	I45203007H
3.	Klarisa DODA	Emri	Florina	F	E Bija	15-12-2003	Beqar/e	Vakuf, Dibër	Shqiptare	K36215007B
4.	Rufie DODA	Emri	Florina	F	E Bija	21-07-2008	Beqar/e	Murnies, Greqi	Shqiptare	K85721006S
5.	Xhelil DODA	Emri	Florina	M	I Biri	08-06-2012	Beqar/e	Hania, Greqi	Shqiptare	L20608065P
6.	Rejan DODA	Emri	Florina	M	I Biri	07-08-2024	Beqar/e	Murnies, Eleftherio Venizelo, Hania, Greqi	Shqiptare	M40807050S
7.	-----									
8.	-----									
9.	-----									
10.	-----									

Kjo certifikatë lëshohet për _____



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e
Përgjithshme e Gjendjes Civile
Date: 2025/09/17 14:23:47 +02'00'
e524cb50a2d04971b3b167dfeb18accd2

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile)

MIRATOHET
BASHKIA DIBER
KRYETARI
RAHIM SPAHIU

Projektuesi: Ing.Edvin SHAHI

Objekti:

RIKONSTRUKSION APARTAMENTI
EMRI DODA

Datë:08-09-2025

PREVENTIV



NR	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	CMIMI	VLEFTA
1. PUNIME SHITESASH 2						
1	2.262/1	Shtrese betoni C 7/10	m3	9.0	13,408.21	120,673.85
2	2.267/1	Shtrese me pllaka porcelanat	m2	88.0	4,131.15	363,540.94
Shuma 1:						484,214.79
2. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI						
3	2.324a	Plintuse pllake grez	m1	56.0	386.88	21,665.22
4	2.310/1	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, li perzier M 25	m2	282.0	801.86	226,125.08
5	2.308/a	Suvatim me grafiato h > 4 m	m2	56.0	2,167.54	121,382.07
6	2.297/b	Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm	m2	88.0	3,348.97	294,709.53
7	2.358/b	Veshje fasade me polisterol t=5cm rrjete + suva.	m2	42.0	4,688.37	196,911.62
8	2.326	Veshje me pllake majolike	m2	24.0	3,323.50	79,759.18
Shuma 2:						940,552.70
3. PUNIME BETONI DHE B/A						
9	2.119/1a	Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m	m3	5.0	27,360.49	136,802.45
Shuma 3:						136,802.45
4. PUNIME HEKUR BETONI						
10	2.166/1a	F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm:	ton	1.0	128,911.85	128,911.85
Shuma 4:						128,911.85
5. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE						
11	2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	m2	26.0	1,432.10	37,234.65

12	2.220	Çati me kapriate metalike me HD 10~12m, mbuluar me plastmas te valezuar	m2	105.0	3,271.96	343,555.80
			Shuma 5:			380,790.45
6. PUNIME MURATURE TULLE						
13	2.70/2	Mur me tulla te lehtsuara deri - 3 m, LL.P. M-25	m3	24.0	17,600.52	422,412.56
			Shuma 6:			422,412.56
7. PRODHIMI I MATERIALEVE TE NDERTIMIT						
14	1.117/p	Pragje dritare me granll	m2	22.0	2,454.37	53,996.10
			Shuma 7:			53,996.10
8. PUNIME DYER DRITARE						
15	2.375/2a	Dritare d/alumini dyfi xh.	m2	5.0	11,649.23	58,246.17
16	2.383/1	F.V. Dyer te brendeshme druri cilesi e I-re.	m2	10.0	21,650.85	216,508.55
17	2.395/a	Dyer d/alumini me mbushje element d/a.	m2	6.0	11,760.94	70,565.65
18	2.386/2	Dyer te blinduara	m2	3.0	44,441.55	133,324.66
			Shuma 8:			478,645.02
9. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE						
19	2.491/d	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16	ml	40.0	535.87	21,434.64
20	2.491/2h	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=110mm, t = 8.1 mm, Pn 10	ml	10.0	1,578.56	15,785.64
21	2.494	F.V. Saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm	copë	2.0	1,175.50	2,351.00
22	2.495	F.V. Lavaman porcelani	copë	1.0	11,653.46	11,653.46
23	2.498	F.V. Lavapjate	copë	1.0	12,408.39	12,408.39
24	2.501	F.V. WC allafrenga	copë	1.0	16,713.47	16,713.47
25	2.506	F.V. Bide porcelan	copë	1.0	7,484.37	7,484.37
26	2.508	F.V. Bolier 100 l	copë	1.0	12,885.43	12,885.43
			Shuma 9:			100,716.40
10. INSTALIME PER NDRICIM						

1. Është e ndaluar rreptësisht të ushtrohet veprimtaria e transportit të udhëtarëve me taksi nga individë dhe subjekte të palicencuar, me licencë të pavlefshme, me licencë të vjedhur, ose të falsifikuar, ose me dokumente udhëtimi të falsifikuara.
2. Strukturat e Bashkisë Dibër në rast të konstatimit të kryerjes së veprimtarisë së jashtëligjshme, kërkojnë nga organet dhe strukturat kompetente shtetërore marrjen e masave për eliminimin e shkeljeve të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 41

Sjellja e drejtuesit të automjetit taksi

Drejtues automjeti mund të jetë vetë subjekti i licencuar ose çdo person i punësuar me kontratë pune të vlefshme. Gjatë kryerjes së shërbimit drejtuesi i automjetit është i detyruar:

1. Të sillet në çdo rast me korrektesë dhe ndjenjë përgjegjësie;
2. Të kryejë rrugën më të shkurtër dhe ekonomike për të shkuar në vendin e caktuar për përdoruesin, me përjashtim të kërkesës së shprehur nga klienti, duke e informuar atë për çdo devijim që do të paraqitet i nevojshëm;
3. Të qëndrojnë në të gjitha vendet e rezervuara për shërbim publik taksi, sipas detajimit të rrugëve me Urdhër Kryetari, të cilat janë pajisur me sinjalistikën përkatëse, duke ju nënshtruar tarifave të përcaktuara me Vendim të Këshillit Bashkiak sipas zonimit;
4. T'u japë ndihmë pasagjerëve gjatë gjithë periudhës së transportit;
5. Të mbajë pastër dhe në gjendje të mirë automjetin;
6. Të parapërgatitë shërbimet e duhura zëvendësuese, në rastet kur mjete e ka të pamundur të çojë deri në fund transportimin për shkak avarie apo aksidenti;
7. Të dorëzojë pranë Zyrës së Licencimit në Bashkinë Dibër, brenda 24 orëve nga përfundimi i shërbimit, çfarëdo objekti të harruar nga klientët në brendësi të mjetit;
8. Të mbajë në efikasitet të plotë instrumentet e mjetit, kujdes të veçantë t'i kushtojë taksimetrit dhe kilometrazhit;
9. T'i dorëzojë pasagjerit faturën tatimore me TVSII, e cila duhet të përmbajë numrin e licencës, datën dhe shumën që tregon taksimetri. Gjithashtu duhet të tregohen shtojcat eventuale ose reduktimi i tarifave të aplikuara;
10. Të mbajë në makinë kopjen e Rregullores aktuale dhe të aktit të tarifave në fuqi dhe t'ia tregojë klientit nëse ky i kërkon;
11. Të ekspozojë në mënyrë të dukshme, në brendësi të automjetit, shenjën dalluese që përmban numrin e licencës, numrin e telefonit të Bashkisë Dibër të cilës do t'i drejtohet për ankime të mundshme lidhur me shërbimin e ofruar.

Neni 42

Ndalimet për drejtuesin e automjetit taksi

Gjatë kryerjes së shërbimit drejtuesit të automjetit i ndalohet:

1. Të refuzojë shërbimin (me përjashtim të personave që gjatë shërbimit të mëparshëm kanë shkaktuar dëmtime të mjetit, kanë pasur sjellje të pahijshme, si dhe të jenë debitorë ndaj tij);
2. Të pranojë në makinë persona të tjerë nga ata që kanë kërkuar shërbimin, me përjashtim të rasteve që ka mirëkuptim,
3. Të transportojë kafshë/shpendë personale gjatë kryerjes së shërbimit;
4. Të ndërpresë udhëtimin me iniciativën e vet (udhëtimi mund të ndërpritet me kërkesën e vetë klientit, ose në rast të forcave madhore apo rreziqeve evidente detyrimisht ndërpritet udhëtimi),
5. Të kërkojë shpërbim shtesë mbi atë të tarifës së llogaritur nga taksimetri (përveç tarifës për bagazhet);

6. Të ndërhyjë në taksimetër apo të kryejë shërbim me taksimeter të fikur, të prishur apo të pavulosur;
7. Të refuzojë transportin e bagazheve që janë brenda normave të lejuara. Veprimet e ngarkim shkarkimit të bagazheve nuk janë të detyrueshme;
8. Të refuzojë transportin e pajisjeve të tilla të nevojshme të klientit, si paterica e të tjera të ngjashme me to, karrocave të fëmijeve apo invalidëve që palosen;
9. Të pijë duhan apo të hajë bukë gjatë krucjes së shërbimit;
10. Të braktisë qoftë edhe përkohësisht mjetin në vendet përkatëse të qëndrimit, përveç rasteve të nevojave të domosdoshme dhe për afate të shkurtra, duke nioftuar udhëtarin;
11. Të kryejë transport vetëm të sendeve apo të mallrave;
12. Ndalohet vendosja në mjetet e transportit të udhëtarëve e fotografive dhe objekteve të tjera me karakter pornografik.

Neni 43 Sjellja e udhëtarëve

Udhëtarët të cilët përdorin këtë shërbim publik (vendas dhe të huaj) kanë këto detyrime:

1. Të paguajnë udhëtimin pasi mbërrin në destinacionin final, duke u bazuar në taksimetër dhe numrin e personave dhe duke mbajtur parasysh se tarifa që duhet të paguajë nuk do të jetë më e ulët se tarifa minimale e udhëtimit;
2. Për transportin e fëmijëve nën moshën e lejuar duhet të jenë të pajisur me mjetet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi (sedilje speciale);
3. Të respektojnë dhe të kërkojnë të respektohet kjo rregullore;
4. Ndalohen të shfrytëzojnë këtë shërbim për veprimtari të paligjshme;
5. Ndalohen të pinë duhan gjatë udhëtimit;
6. Ndalohen të hedhin objekte nga automjeti, qoftë në ndalim apo lëvizje;
7. Ndalohen të bëjnë pis ose të dëmtojnë mjetin;
8. Ndalohen të kërkojnë transportimin e kafshëve/shpendëve shtëpiake pa rënë dakord me taksistin;
9. Ndalohet transportimi i kafshëve/shpendëve të egra;
10. Ndalohen të kërkojnë që transporti të bëhet në kundërshtim me rregullat e sigurimit dhe të sjelljes të parashikuar në Kodin Rrugor;
11. Ndalohen të hapin dyert gjatë udhëtimit dhe të zbresin pa miratimin e drejtuesit të mjetit.

Neni 44 Zëvendësimi i përkohshëm i drejtuesit të automjetit

1. Subjekti i licencuar ose të punësuarit me kontratë të vlefshme pune, mund të zëvendësohen përkohësisht nga drejtimi i taksisë në rastet e mëposhtme:
 - a) Për shkak të shëndetit, paafësisë së përkohshme, barrës dhe të qenit lehonë;
 - b) Për thirrjen nën armë;
 - c) Për një periudhë jo më shurnë se 30 ditë në vit për arsye personale;
 - d) Për pezullim ose heqjen e përkohshme të patentës;
 - e) Në rast të impenjimeve sindikaliste apo publike (jo me shume se 30 ditë);
 - f) Gjatë kryerjes së lejes së pushimit vjetor.
 - g) Etj.
2. Raporti me zëvendësuesin mund të rregullohet me kontrata pune me kohë të caktuar.

3. Titullari i licencës që zëvendësohet përkohësisht sipas rasteve të parashikuara në pikën 1, gërma 'a', 'b' dhe 'd' kur është më shumë se 30 ditë, të këtij neni, duhet të paraqesë pranë strukturave të licencimit dokumentet e nevojshme për zëvendësuesin, si me poshte:

- u) Kontratën e punës
- b) Lejen e drejtimit në kategorinë përkatëse;
- c) Dëshminë e aftësisë profesionale;
- d) Formularin për deklarinimin e gjendjes gjyqësore;
- e) Dëshmi penaliteti;
- f) Vërtetim nga prokuroria;
- g) Vërtetim nga gjykata.

Neni 45

Ndërprerja e transportit

1. Në rastet, në të cilat transporti duhet të ndërpritet për avari, aksident ose për shkaqe të tjera të forcës madhore pa qenë e mundur të organizohet shërbim zëvendësimi, udhëtari ka të drejtë të braktisë mjetin duke paguar vetëm vleftën e rrugës së kryer.

2. Shërbimi mund të ndërpritet edhe në rastet në të cilat udhëtari shfaq haptazi gjendje psikike të rënduar, shfaqje agresive apo dhunë, të tilla që mund të dëmtonin sigurinë e vet apo të tjerëve.

1 Në rast të prishjes së taksimetrit, taksisti duhet të ndërpresë shërbimin, duke hërë të mundur përfundimin e udhëtimit nëpërmjet automjeteve të tjera të licencuara në shërbimin taksi dhe të bëjë riparimin apo zëvendësimin e taksimetrit brenda 7 ditëve,

Neni 46

Mënyra e pajtimit të automjetit taksi

1. Pajtimi i një automjeti në shërbimin taksi është një kontratë e heshtur, ndërmjet drejtuesit të automjetit (në emër dhe për llogari të poseduesit të licencës) dhe udhëtarit.

2. Forma të pajtimit janë si me poshtë:

- a) Nëpërmjet telefonit, apo mënyrave të tjera të telekomunikacionit;
- b) Me paraqijen e udhëtarit në vendparkimin e taksisë;
- c) Me prenotim të parakohshëm.

Neni 47

Përdorimi i taksimetrit

1. Taksimetri duhet të vihet në funksionim, për tipin e tarifës që do të adoptohet, në varësi të pajtimit të automjetit taksi.

2. Funksionet kryesore të taksimetrit të lidhura me shërbimin (i lire - i zëne -parkim), duhet të jenë të lidhura me një tabelë të ndriçuar në pjesën e sipërme të kabinës së automjetit.

3 Në përfundim të udhëtimit, drejtuesi i automjetit ka për detyrë të informojë klientin mbi mënyrën e përlogaritjes së tarifës që duhet të paguajë.

4. Automjetet që ushtrojnë aktivitetin e shërbimit taksi, duhet të kenë të instaluar aparatit e numërimit të kilometrave, si të përgjithshme ashtu dhe të pjesshrne.

5. Në rastet e defektit të aparatit të numërimit të kilometrave, taksisti duhet të ndërpresë shërbimin dhe duhet të marrë masat për riparimin e tij brenda 7 ditëve.

Neni 48

Transporti i invalidëve

1. Drejtuesi i automjetit ka për detyrë të ofrojë asistencën e nevojshme gjate gjithë fazave të transportit, duke përfshirë këtu dhe ngjitjen apo zbritjen nga automjeti të udhëtarëve invalid, si dhe të pajisjeve që i nevojiten atyre për të lëvizur.
2. Transporti i karrocave, i qenve guide që i shërben invalidit për t'i treguar rrugën dhe i pajisjeve të tjera ndihmësc, kryhen falas (nuk llogariten si bagazh).
3. Periudha kohore e cila harxhohet për të hipur dhe për të zbritur personin invalid nga automjeti nuk do të merret parasysh në çmimin e udhëtimit.
4. Të gjitha përgjegjësitë e mundshme që vijnë nga ushtrimi i këtij aktiviteti, i ngarkohen vetëm poseduesit të licencës.

Neni 49

Shërbimet jashtë rrethit të regjistrimit

1. Automjeti i licencuar taksi që kryen shërbimin jashtë rrethit të regjistrimit të tij duhet të jetë i pajisur me dokumentin e udhëtimit nëpërmjet agjencive të licencuara për transport udhëtarësh.
2. Dokumenti i udhëtimit duhet të plotësohet në të gjitha kërkuesat, që përfshin: numrin e licencës së agjencisë, emrin ose emrin tregtar të subjektit agjenci transporti, emrin ose emrin tregtar të subjektit të licencuar, numrin e licencës të subjektit transportues, emërtimin e bashkisë, emrat e personave që udhëtojnë, numrin e identifikimit, emri i agjentit dhe nënshkrimi i tij, numri i telefonit dhe vula e agjencisë.
3. Dokumenti i udhëtimit i lëshohet nga agjencia, subjektit në shërbimin taksi, mbi bazën e një marrëveshjeje kontraktuale ndërmjet tyre. Agjencia nuk ka të drejtë t'i lëshojë dokument udhëtimi subjekteve në shërbimin taksi të pakontraktuar. Subjekti në shërbimin taksi nuk ka të drejtë të kërkojë dokument udhëtimi nga agjenci me të cilat nuk ka lidhur marrëveshje kontraktuale.
4. Rastet e evidentuara në kundërshtim me pikën 1, 2, 3 të këtij neni, përbëjnë arsye deri në heqjen e licencës.
5. Drejtuesi i automjetit taksi, pas kryerjes së shërbimit të prenotuar/rezervuar kthen dokumentin e udhëtimit në agjencinë ku e ka tërhequr atë, menjëherë me përfundimin e shërbimit, duke ruajtur për vete një fotokopje të saj. Në rast se drejtuesi i automjetit taksi nuk kthen dokumentin e udhëtimit, agjencia që ka lëshuar këtë dokument njofton zyrtarisht organet dhe strukturat e kontrollit, të cilat marrin masa për plotësimin e këtij kushti.
6. Blloku i udhëtimeve me kopjet e listës së udhëtarëve, qëndron në agjenci dhe në cdo moment është subjekt kontrolli nga autoriteti kompetent që licencën agjencinë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit rrugor, që lëshoi bllokun e udhëtimit, si dhe organet e autorizuar me ligj.
7. Organet dhe strukturat e kontrollit në rrugë, ushtrojnë kontrolle ndaj të gjitha automjeteve taksi, nëse procedurat e operimit të automjetit taksi janë të rregullta, të cilat në kthim transportojnë udhëtarë.

Neni 50

Strukturat e kontrollit

1. Strukturat kryesore kompetente për të kontrolluar subjektet për përmbushjen e detyrimeve në zbatim të legjisllacionit në fuqi dhe kësaj rregulloreje janë:
 - a) Policia Bashkiake;
 - b) Grup kontrolli i autorizuar nga Kryetari i Bashkisë;
 - c) Strukturat e tjera shtetërore të ngarkuara me ligj apo akte nënligjore.

2. Për konstatimin e kundërvajtjes administrative, përveç rasteve kur parashikohet marrja e gjobës në vend, mbahet procesverbal nga personat e ngarkuar me ligj ose me akte nënligjore.
3. Procesverbali mbahet në vendin e kryerjes së kundërvajtjes dhe në kohën e konstatimit të saj, si rregull në prani të kundërvajtesit dhe të dëshmitarëve të pranishëm, Në procesverbal shënohen identiteti i kundërvajtesit dhe lloji i kundërvajtjes, Në procesverbal nënshkruajnë konstatuesi, kundërvajtësi dhe dëshmitarët e pranishëm, në rast se ka. Procesverbali i dërgohet menjëherë strukturës që është kompetente për shqyrtimin e kundërvajtjeve,

Neni 51

Masat dhe sanksionet administrative

1. Kundërvajtjet administrative të konstatuara si të tilla, shqyrtohen sipas ligjit nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet administrative", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, si dhe vendimeve përkatëse të Këshillit Bashkiak.
2. Për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi dhe të kësaj rregulloreje, struktura e liçencimit ndërmer këto masa;
 - a) Paralajmërim për revokim liçence;
 - b) Propozim për pezullim liçence (Liçenca pezullohet me vendim të Kryetarit të Bashkisë);
 - c) Propozim për revokim liçence (Liçenca revokohet me vendim të Kryetarit të Bashkisë);

Neni 52

Masa e paralajmërimit

- Paralajmërimi sipas pikës 2, germa 'a' të nenit 51, konsiston në një thirrje zyrtare të subjektit, nga struktura kompetente për tërheqjen e vërnendjes për zbatimin e rregullores ose njoftimin me shkrim të masës administrative të marrë ndaj këtij subjekti.
2. Masa e paralajmërimit merret në rastet kur subjekti:
 - a) Përshkon një rrugë më të gjatë (pra që është në disavantazh ekonomik për klientin), përjashtuar rastet e detyrueshme;
 - b) Nuk lëshon faturën e çmimit kur kërkohet nga klienti, ose e lëshon atë jo të rregullt;
 - c) Kur nuk jep ndihmën e nevojshme për udhëtarët invalid, përveç rasteve që janë të parashikuara në rregullore,
 - d) Refuzon të transportojë pajisjet e nevojshme që i duhen një personi për të lëvizur, apo rrit në mënyre jo të drejtë çmimin e udhëtimit për invalidët;
 - e) Kur i kërkon një klienti një shumë më të madhe se ajo e parashikuar për gjatesinë e udhëtimit duke futur në mënyrë të padrejtë tarifa shtesë;
 - f) Kur kryen shkelje të tjera në kundërshtim me kërkesat e nenit 42 të kësaj rregulloreje.

Neni 53

Masa e pezullimit

1. Masat e pezullimit të përkohshëm të liçencës janë si më poshtë:
 - 1.1 Struktura e liçencimit propozon për pezullimin e liçencës për një minimum prej 5 (pesë) ditësh deri në një maksimum prej 20 (njëzet) ditësh në rastet kur taksisti:
 - a) Kryen një shërbim ndaj udhëtarëve me taksimetrimin e fikur (Përjashtohet rasti kur drejtuesi i automjetit vërteton se taksimetri ka qenë në gjendje pune në momentin e fillimit të udhëtimit, Për këtë rast udhëtarit i kërkohet vetëm tarifa minimale e udhëtimit);

b) Kur kryen të njëjtën shkelje për të cilën ka marrë paralajmërim

1.2 Struktura e liçencimit propozon për pezullimin e liçencës për një minimum prej 1 (një) muaji deri në një maksimum prej 6 (gjashtë) muajsh, në rastet kur taksisti:

- a) Kur ushtron aktivitet në gjendje të dehur, periudha e pezullimit të liçencës nuk mund të jetë në të njëjtën kohë me pezullimin e patentës apo lejes së qarkullimit;
- b) Kur kryen shkelje në kundërshtim me kërkesat e nenit 49 të kësaj rregulloreje;
- c) Kur kryen shkelje për të cilën është marrë njëherë masa e pezullimit sipas pikës 1.1 të këtij neni.

2. Brenda një periudhe prej 3 ditësh duhet të bëhet dorëzimi i liçencës pranë strukturës së liçencimit. Ridorëzimi i liçencës bëhet në fund të periudhës së pezullimit të parashikuar.

Neni 54 **Revokimi i liçencës**

Liçenca revokohet kur:

- a) Subjekti i shërbimit taksi i liçencuar nuk i ploteson më kushtet për të cilat është liçencuar (të ketë reputacion të mirë; të ketë besueshmëri financiare; të ketë kompetencën profesionale të nevojshme për kryerjen e shërbimit);
- b) Subjektit të liçencuar gjatë një afati kohor prej pesë vitesh i është pezulluar liçenca për një afat kohor mbi 6 (gjashtë) muaj.

Neni 55 **Efektet që vijnë nga pezullimi, revokimi apo heqja dorë e liçencës**

Në rastet e pezullimit, revokimit dhe heqjes dorë nga liçenca, Bashkia Diber nuk i detyrohet subjektit-asnjë zhdëmtim. Subjekti është i detyruar të shlyejë të gjitha detyrimet ligjore për periudhën e pezullimit ose revokimit të liçencës.


Neni 56 **Hyrja ne fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Këshilli Bashkiak Diber si dhe pas konfirmimit nga ana e Prefektit të Qarkut Diber.

Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore

Drejtori

Fitim Raska



Sektori i Liçencimit dhe Kontrollit

Altin Tomcini



KRYETARI

Rahim Spahiu

Në mungesë dhe me porosi

Lorenç Cibaku

